



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 694 Prot.

Tiranë, më 28.04.2022

V E N D I M

Nr. 83 , Datë 28.04.2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 65, datë 12.04.2022, të paraqitur nga znj. A.Ç kundër Spitalit Rajonal Berat dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në të cilën pretendohet diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja A.Ç, ka parashtruar se, është emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjëse e materialeve”, pranë Shërbimit të Urgjencë-Pranimit të Spitalit Rajonal Berat, me urdhrin nr. 649 prot., datë 01.06.2016, detyrë të cilën e ushtron prej 6 vitesh. Detyrat dhe përgjegjësitë mbi detyrën e ushtruar burojnë nga Kontrata e Punës dhe Rregullorja e Brendshme.

Në datën 04.02.2020, nëpërmjet e-mailit zyrtar, ankuesja deklaroi se është njohur me urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë Nr. 224, datë 01.04.2020 “*Për emërimin e listave emërore të përfituesve*”, përfshirë edhe ditët e angazhimit në disgnostifikimin dhe trajtimin mjekësor, të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19, për muajin mars 2020, si edhe me VKM 270/2020, e cila në mënyrë të përmblendhur parashikon dhënien e shpërblimeve mujore dhe vlerat përkatëse për personelin mjekësor, specialistët e shëndetit publik, infermierët, të angazhuar në diagnostifikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19 dhe personelin mbështetës të angazhuar në këto institucione në këtë periudhë.

Lista e përfituesve është bërë publike, duke përfshirë të gjithë punonjësit në këtë angazhim. Pavarësisht angazhimit, ankuesja pretendon se nuk ka përfituar sipas përcaktimeve ligjore, por ka

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

përfitur vetëm vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në muajin tetor 2021 dhe më pas nuk ka marrë asnjë përfitim tjetër financiar, përgjatë gjithë periudhës që ka kontribuar.

Në datën 12.11.2021, me shkresën nr. 4215 prot., ankuesja informon se ka bërë kërkesë për përfitim financiar, bazuar në VKM 207/2020 që nga hyrja në fuqi e këtij vendimi e në vazhdim. Kjo kërkesë është mbështetur dhe nga deklaratat nr. 4215 prot., datë 12.11.2021, lëshuar nga Xh.G, në pozicionin Shef i Shërbimit të Urgjencë Pranimi dhe Kryeinfermieres, të cilët kanë konfirmuar ushtrimin e detyrës nga ankuesja gjatë gjithë kësaj kohe në Spitalin Rajonal, sipas përgjegjësisë dhe detyrave të punës, duke shërbyer si personel mbështetës pranë pacientëve me Covid-19, përgjatë gjithë periudhës së pandemisë. Ankuesja deklaron se nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare në lidhje me këtë kërkesë.

Sipas ankuses, në listën e përfituesve gjenden emrat e personelit mbështetës që me të drejtë u takon shpërblimi, por që janë në të njëjtat kushte me të. Për këtë arsye, ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë edhe pse është në kushte të njëjta me ta. Sipas saj, detyrat dhe profili i saj i punës është i tillë që ajo duhet të hyj në pavion personalisht, të kujdeset për vendosjen në pavion të bazës materiale si dhe të largojë bazën materiale të përdorur. Kjo bën që ajo të jetë drejtpërdrejtë e ekspozuar ndaj infeksionit Covid-19, por injorohet nga drejtuesi i Spitalit Berat si dhe nga Ministri i Shëndetësisë.

Ankuesja pretendon se, ky trajtim i pabarabartë përbën “diskriminim” në kuptim të ligjit, ndaj kërkon që të trajtohet nga Komisioneri, si një rast që vërtet përbën diskriminim. Sa i takon shkakut të mbrojtur, ligji parashikon si shkak të mbrojtur edhe çdo shkak tjetër. Duke qenë se nuk e ka zbuluar ende se cili është shkakut që po trajtohet në mënyrë të pabarabartë, ankuesja vlerëson se kërkesa e saj duhet të pranohet për shqyrtim, duke u kualifikuar sipas ligjit në rastin e diskriminimit për çdo shkak tjetër.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit nga ana e Spitalit Rajonal Berat dhe marrjen e masave për eliminimin e pasojave nga trajtimi i pabarabartë, duke i caktuar dhe akorduar masën përkatëse të shpërblimit që i takon sipas ligjit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i*

kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar², rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD, përcaktohet se : “*1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.*”

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim,

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën LMD.

por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “*për çdo shkak tjetër*”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “*çdo shkak tjetër*” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit “*çdo shkak tjetër*” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “*shkakun*” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “*çdo shkak tjetër*”. Rezulton se, për të patur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, i cili në bazë të ligjit është i ndaluar ose i mbrojtur.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses se është diskriminuar “*për çdo shkak tjetër*” pa identifikuar asnjë shkak konkret, i cili më pas të vlerësohej nga ana e Komisionerit nëse përbën ose jo një shkak që gëzon mbrojtje, nuk përbën një pretendim për diskriminim, sipas parashikimeve të LMD-së.

Komisioneri thekson se, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese. Që një sjellje e paligjshme të konsiderohet si diskriminuese, duhet që pala ankuese minimalisht të identifikojë dhe të provojë shkakun e pretenduar. Në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesja nuk ka identifikuar një shkak për të cilin pretendon se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme, pra për të cilin pretendon se është diskriminuar.

Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankueses nuk konsiderohen pretendime për diskriminim, dhe për rrjedhojë ankesa e paraqitur është e papajtueshme me dispozitat e LMD. Bazuar në nenin 32/1/a, të LMD, Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë vetëm ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj.

Bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në neni 33, pika 4, germa “b”, të LMD, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e LMD dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 65 regj., datë 12.04.2022, të paraqitur nga znj. A.Ç kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Spitalit Rajonal Berat, pasi është e papajtueshme me dispozitat ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Hartoi: K. Keta, Inspektore, DHA
Rishikoi: Rigert Babaj, Inspektor, DHA
Miratoi: V. Bushati, Drejtore DHA
Datë: 21.04.2022